



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER EMIL P. BARÇI
ADRESA KONGRESI I ELBASANIT,
28 NENTORI, NR.36, KATI I PARE
TEL: 692087200



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1121

Nr. koleksioni: 422

Elbasan më 24/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020010830036559563

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



TRASA E PULLES
I J LIKUJDUA



A2020010830036559563

KONTRATË SHITJE

(kuotash kapitali themeltar ne SH.P.K.)

Sot, në datë **24.10.2020**, para meje noterit Emil P. Barçi, me seli në qytetin e Elbasanit, lagja "Kongresi i Elbasanit", rruga "28 Nëntori", pall. 36, kt.1, u paraqitën palët kontraktuese :

- Në cilësinë e shitësit : **ALMA KABASHI**, atësia Mislim, e dtl. 03.03.1971, lindur në Gramsh, banuese në Elbasan, pajisur me letërnjoftim nr. 030622444, me NID - **H15303070W**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Sipas çertifikatës familjare vulosur elektronikisht në datë 24.10.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, shitësja Alma Kabashi rezulton me gjendje civile "e martuar", me z. **Arben Sharra**, atësia Mustafa, i dtl. 19.07.1969, lindur dhe banues në Elbasan, pajisur me pasaportë nr. BB0498155, me NID - **G907191220**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Në bazë të Kodit të Familjes, meqenëse midis shitëses dhe bashkëshortit të saj, ekziston regjimi pasuror martesor në bashkësi, dhe se meqenëse pasuria e luajtshme, objekt i kësaj kontrate shitje, është fituar me shit-blerje, gjatë martesës së tyre, ata do të konsiderohen bashkëpronarë me pjesë të barabarta të saj, duke bërë të detyrueshëm dhënien e pëlqimit nga z. Arben Sharra.

- Në cilësinë e blerësit : **OLSI DEDJA**, atësia Ilir, i dtl. 27.04.1977, lindur dhe banues në Elbasan, pajisur me letërnjoftim nr. 036309310, me NID - **H70427197K**, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Sipas çertifikatës familjare vulosur elektronikisht në datë 24.10.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, blerësi Olsi Dedja, rezulton me gjendje civile "i martuar", me zj. **Irma Dedja**, atësia Ali, e dtl. 15.04.1979, lindur në Burrel, Mat, banuese në Elbasan, me NID - **H95415191S**.

Prej tyre u kërkua redaktimin e kësaj kontrate shitje për pasuri të luajtshme, sipas kushteve të mëposhtme :

- Objekt i kësaj kontrate është shitja tërësisht e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. nga ortaku i vetëm Alma Kabashi, në favor të blerësit Olsi Dedja.

- Shoqëri tregtare "B&B Fashion" sh.p.k. është regjistruar në Q.K.B. në datë 23.09.2013, pajisur me NIPT - **L33323201D**, me seli në Ish-Nish Vaji, Elbasan, me ortak të vetëm zj. Alma Kabashi, që zotëron 100 % të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Sipas ekstraktit historik marrë elektronikisht në datë 24.10.2020, nëpërmjet portalit e-Albania, në Qendren Kombëtare të Biznesit, rezulton se shoqëria tregtare është me status "aktiv" dhe nuk ka të regjistruar asnjë akt ligjor që kufizon transferimin e pronësisë të kuotës së kapitalit.

- Sipas konfirmimit të marrë elektronikisht në datë 24.10.2020, nga Regjistri i Barrëve Siguroese, nuk ka të regjistruar asnjë akt ligjor në ngarkim të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. dhe të ortakut të vetëm Alma Mislim Kabashi.



Palët kontraktuese deklarojnë se kanë caktuar si çmim shitje për **100 %** e kuotës së kapitalit themeltar, vlerën monetare **100.000 Lekë** (njëqindmijë), e cila është transferuar nga blerësi, tek shitësi, tërësisht në Cash, dhe jashtë kësaj zyre noteriale.

Shitësja deklaron se garanton se deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga ana e tij, janë shlyer të gjitha detyrimet tatimore, lidhur me tatim fitimin, akcizën, tatimin mbi të ardhurat personale, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, e taksat vendore si dhe nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për transferimin e pronësisë së kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie tregtare.

- Blerësi deklaron se, merr përsipër çdo detyrim ligjor dhe financiar, që rrjedh nga zotërimi i kuotës së kapitalit të shoqërisë, nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me nënshkrimi i kësaj kontrate shitje nga palët kontraktuese, kuota e kapitalit themeltar të shoqërisë "B&B Fashion" sh.p.k. do të rezultojë tërësisht në pronësi të z. Olsi Dedja.

Blerësi, në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", duhet të kryejë regjistrimin e kontratës pranë Q.K.B.-së.

- Kontrata ju lexua nga unë noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë palëve kontraktuese, dhe prej tyre u deklarua se e kuptuan përmbajtjen dhe u njohën me efektet juridike që rrjedhin prej saj. Palët kontraktuese me vullnet të lirë e të plotë, e nënshkruan atë përpara meje noterit.

- Bashkalidhur kontratës është : dokumentacioni pronësor i pasurisë së paluajtshme, certifikatat familjare, deklarata noteriale për kalimin e çmimit të blerjes, fotokopjet e dokumentacionin identifikues.

- Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri, deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kontrata u redaktua në katër kopje të njëjta, të cilat pasi u lexuan nga palët kontraktuese, me vullnet të të lirë e të plotë, u nënshkruan para noterit. Bashkangjitur kontratës është një kopje e vendimit të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

Shitës

ALMA KABASHI

Alma Kabashi
Ku

Blerës

OLSI DEDJA

Olsi Dedja
Dedja

Bashkëshorti i shitëses

ARBEN SHARRA

Arben Sharra
Sharra

Noter

EMIL P. BARÇI

Barçi



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit:	D-20201024112716885
Data e Rezultatit te Kerkimit:	24.10.2020
Ora e Rezultatit te Kerkimit:	11:27:16AM
Lloji i Kerkimit:	
Numri i Dokumentit:	D-400-104-1616
Referenca e Perdoruesit:	

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ALMA MISLIM KABASHI
B & B FASHION SH.P.K.



Ado